



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARA UNIVERSITAR VLORE HIMARË

Nr. 313 Prot

Datë 04.02.2026

SHPALLJE E PROCEDURAVE TË KONKURRMIT PËR NËNDREJTOR TË
INSTITUCIONEVE ARSIMORE PUBLIKE

Në mbështetje të ligjit nr.69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligji nr. 44/2023 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 99, datë 27.2.2019, "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar" i ndryshuar, Udhëzimit nr 22 , datë 13.11.2023 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar",

Ju njoftojmë se shpallen procedurat e konkurrencës për pozicionin "Nëndrejtor" për gjimnazin "Ali Demi" Vlorë dhe Shkollën 9 vjecare "Ismail Qemali" Vlorë.

Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e nëndrejtorit në institucionin publik arsimor parauniversitar do të dorëzohet sipas afateve dhe përcaktimeve të njoftimit.

1) Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar për pozicionin nëndrejtor në institucion publik arsimor parauniversitar:

- Të zotërojnë arsimim si mësues sipas përcaktimeve të nenit 57 të ligjit Nr.69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Të ketë të paktën kategorinë "Mësues i kualifikuar" me vlerësimin jo më pak se "Mirë" në kualifikimin e fundit;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi në ligj;
- Të jetë i certifikuar nga shkolla e drejtoreve ;

2) Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e nëndrejtorit në institucionin publik arsimor parauniversitar:

- Jetëshkrimin (sipas modelit në shtojcën nr.1 të Udhëzimit Nr.22, datë 13.11.2023 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar");
- Kopje e librezës së punës;

- g) Kopje e dokumentit të identifikimit (ID)
- h) Tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 5 të udhëzimit)
- i) Certifikatën e drejtuesit të IPAP-së
- j) Vetëdeklarimin e gjendjes gjatë punës sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2 të udhëzimit);
- k) Vërtetim nga institucioni ku punon që aplikanti nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- l) Deklaratën për verifikimin e vërtetësisë të dokumentacionit të paraqitur nga kandidati sipas shtojcës 8 të udhëzimit.
- m) Deklaratën e konfliktit të interesit të aplikantit me punonjësit arsimorë të IPAP-së (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prind të bashkëshortit/es,) (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3 të udhëzimit);
- n) Dokumentacioni i aplikimit nga kandidatët dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në adresën e IPAP ose në adresën elektronike të IPAP-së .
- o) Dorëzimi i dokumentacionit kryhet jo më vonë se dhjetë dite pas shpalljes së njoftimit të vendit të lirë për nëndrejtor të IPAP-së
- p) Dokumentacioni dorëzohet brenda 10 ditëve pas shpalljes së njoftimit të vendit të lirë për nëndrejtor.

c) Komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e nëndrejtorit.

1-Komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit ngrihet nga drejtori i IPAP-se, mbledhet në mjediset e IPAP-së jo më vonë se 3 (tri) ditë pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dokumentacionit të aplikimit për nëndrejtor të IPAP-se dhe kur është e pranishme shumica e anetareve të tij.

2-Komisioni bën shqyrtimin paraprak të dokumentacionit për mangësi brenda 2 (dy) ditëve pune nga mbledhja e Komisionit dhe njofton me shkrim në adresën e mail kandidatin për mangësitë e konstatuara në dokumentacion.

Kandidati nga momenti i njoftimit ka 3 (tri) ditë pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dokumentacionit për të dorëzuar dokumentacionin që mungon.

3-Pas përfundimit të këtij afati, komisioni liston aplikantët të cilët kanë dokumentacionin të plotë dhe të saktë, bën vlerësimin me pikë për aplikantët e pranuar si candidate për nëndrejtor të IPAP-se , sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 6 të Udhëzimit , brenda 2 (dy) ditëve pune nga listimi i aplikantëve.

4-Realizon intervistën e strukturuar në të cilën kandidatët për fushat e njohurive dhe aftësite për drejtimin e institucionit . Çdo anëtar i Komisionit bën vlerëson intervistën me pikë nga 1 në 10 brenda 1 (një) ditë pune.



5-Komisioni harton tabelat e pikëve dhe rendit kandidatët sipas shumës së përgjithshme të pikëve në rendin zbritës.

6-Brenda 3(tri) ditë punë, pas përfundimit të intervistave shpall në këndin e njoftimeve të IPAP-së tabelat e pikëve totale të secilit kandidat , sipas shtojcës 7 bashkëlidhur të Udhëzimit.

7-Kandidatët kanë të drejtë të paraqesin ankim me shkrim para Komisionit brenda 3 (tri) ditëve pune nga shpallja e rezultateve të konkurrimit. Komisioni shqyrton ankesat brenda 1 (një) dite pune.

8-Kryetari i Komisionit i dorëzon drejtorit të IPAP-së dosjet e aplikimit dhe vlerësimet me pikë për dy kandidatët me më shumë pikë. Kopjet e këtyre dokumenteve dhe dosjet e aplikanteve të tjere ruhen në arkivën e institucionit në përputhje me afatet kohore të parashikuara në legjislacionin në fuqi për arkivat.

d) Procedura e emërimit të nëndrejtorit të IPAP-se nga drejtori i IPAP-së.

1. Drejtori i IPAP-së, shqyrton dokumentacionin e Komisionit dhe e kthen atë, vetëm nëse konstaton parregullësi të natyrës teknike.
2. Drejtori i IPAP-së brenda 3 (tri) ditëve pune pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Komisioni, interviston dy kandidatët.
3. Intervistat dokumentohen nga sekretari i institucionit ose nga një mësues i ngarkuar nga drejtori i IPAP-së dhe arkivohen në IPAP, në përputhje me afatet kohore të parashikuara në legjislacionin në fuqi për arkivat.
4. Brenda brenda 3 (tri) ditëve pune nga realizimi i intervistës me kandidatat, drejtori i IPAP-së shpall vendimin për kandidatin fitues për pozicionin e nëndrejtorit të IPAP-së.
5. Kandidati jofitues ka të drejtë të paraqesë ankesë në ZVAP brenda tri ditëve pune nga shpallja e kandidatit fitues.
6. Drejtori i ZVAP-së shqyrton ankesën dhe jep përgjigjen brenda 3 (tri) ditëve pune, pas përfundimit të afatit për ankim.
7. Drejtori i IPAP-se bën emërimin e nëndrejtorit të IPAP-së . Vendimi i emërimit i komunikohet zyrtarisht nëndrejtorit të sapoemëruar.
8. Nëndrejtori i IPAP-së nuk duhet të bëj pjesë , pas emërimit, në forumet drejtuese të partive politike.

Bashkëlidhur këtij njoftimi do të gjeni vendet vakante për pozicionin nëndrejtorit të IAP-ve publike.

DREJTOR

GENTIOLA SHEHU



Lista me vendet vakante për pozicionin “Nëndrejtör” të IAP-ve publike:

Nr	DRAP	ZVAP	Bashkia	Emri i institucionit publik arsimor parauniversitar
1	Fier	Vlorë Himarë	Vlorë	Gjimnazi “Ali Demi” Vlorë
2	Fier	Vlore-Himare	Vlore	Shkolla 9-vjecare “Ismail Qemali” Vlorë

